

<b>1. Titulli i projektit:</b>	Përforcimi i Rrjetit të Tensionit të Ulët 2014 – Dislokimi i njehsorëve  Distrikti i Mitrovicës
<b>2. Përshkrimi i projektit:</b>	<p>Fushëveprimi i këtij projekti përfshin furnizimin me material, instalimin, testimin dhe komisionimin kryesisht të rrjetit të tensionit të ulët 0.4 kV të shpërndarjes në regionet e Distriktit të Mitrovicës. Projekti përfshin ndërtimin dhe komisionimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Linjave ajrore 10(20) kV;</li><li>• Rrjetin e Tensionit të Ulët 0,4 kV;</li><li>• Vendosjen e ormanëve jashtë oborreve të konsumatorëve dhe zhvendosjen e njehsorëve (pikës matëse)</li></ul> <p><b>Arsyetimi:</b> Rrjeti i vjetruar i distribuimit të energjisë i trashëguar nga KEDS nuk garanton cilësi dhe siguri të furnizimit me energji. Si rrjedhojë e rrjetit të vjetruar dhe rritjes së numrit të konsumatorëve të amvisërisë (rezidencial) dhe komercial dhe rrjedhimisht rritjes së konsumit të energjisë, kapacitetet aktuale nuk i plotësojnë kriteret teknike dhe si pasojë cilësia e furnizimit deri tek konsumatori i fundit, nuk është në nivel të kënaqshëm dhe në kufijtë e kërkuar teknik.</p> <p>Për më tepër, rreth 3800 konsumatorët do të ndikohen drejtpërdrejt nga 13 projektet që janë duke u implementuar bashkë me këtë projekt. Konsumatorët që do të përfitojnë nga këto projekte</p>

	<p>janë furnizuar përmes linjave të gjata dhe të vjetruara 0,4 kV dhe aktualisht janë duke u përballur me rënie të tensionit sidomos gjatë orëve të pikut (shfrytëzimit maksimal) të energjisë elektrike.</p> <p><b>Objektivat e projektit janë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i kualitetit dhe rritja e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike;</li> <li>• Përkrahja e rritjes së ngarkesës;</li> <li>• Eliminimi i fyteve të ngushta;</li> <li>• Reduktimi i humbjeve teknike;</li> <li>• Reduktimi i rënieve të tensionit;</li> <li>• Reduktimi i orëve të humbura për konsumator (SAIDI, SAIFI). etj.</li> </ul>
<b>3. Data e fillimit:</b>	16 prill 2014
<b>4. Data e përfundimit:</b>	31 dhjetor 2014
<b>5. Kostoja e projektit</b>	1,0 milion €
<b>6. Sponsor i projektit:</b>	KEDS, Divizioni i Rrjetit
<b>7. Njësia Sponsor:</b>	Departamenti për Kontrollin e Investimeve

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i projektit</b>	<b>Data e fillimit</b>	<b>Data e përfundimit</b>
1	TS 10/0,4 kV Shkolla Shupkovc	16.04.2014	31.05.2014
2	TS 10/0,4 kV Kosova Petrol	03.05.2014	01.07.2014
3	TS 10/0,4 kV NR 6	10.05.2014	31.07.2014
4	TS 10/0,4 kV NR 5	21.05.2014	31.07.2014
5	TS 10/0,4 kV NR 3	26.05.2014	31.07.2014
6	TS 10/0,4 kV Enti per Inkuadrim	28.05.2014	31.12.2014
7	TS 10/0,4 kV Deliqët	30.05.2014	31.07.2014
8	TS 10/0,4 kV Topanica	06.06.2014	31.12.2014
9	TS 10/0,4 kV Tunel i Parë	09.06.2014	31.12.2014
10	TS 10/0,4 kV C (JakupCeraja)	13.06.2014	31.12.2014
11	TS 10/0,4 kV B (HAMZA)	18.06.2014	31.12.2014
12	TS 10/0,4 kV A (TMK)	23.06.2014	31.12.2014
13	TS 10/0,4 kV Sabit Istogu	01.07.2014	31.12.2014